

Loira

Urgjente



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr 3962 Prot.

Gramsh më 25.09/2026

Lënda: Mbi pezullimin e procedurës së aplikimit në kuadër të “Paketës së Maleve”

Znj.BLERINA SINANI

Z. NDERIM SINANI

Adresa:fshati Tërvol ,Njësia Administrative Pishaj

Në kuadër të procedurës së zbatimit të Ligjit nr. 20/2025 “Për Paketën e Maleve”, dhe në fazën e publikimit të listës paraprake të aplikuesve, Bashkia Gramsh njofton se për aplikimet e paraqitura nga:

1. Znj. Blerina Sinani
2. Z.Nderim Sinani

pezullohet përkohësisht vijimi i procedurës, për shkak se pasuritë objekt të këtyre aplikimeve ndodhen në një zonë për të cilën rezulton të jetë parashikuar një projekt zhvillimor nga bashkia Gramsh .Për këtë arsye, përpara vijimit të procedurës dhe përfshirjes së aplikimeve në fazat e mëtejshme, është e nevojshme të kryhen verifikimet dhe të merret informacioni lidhur me shtrirjen e projektit zhvillimor dhe ndikimin e tij mbi pasuritë objekt të aplikimeve.

Në këto kushte, aplikimet e sipërcituara **mbeten të pezulluara deri në përfundimin e verifikimeve dhe marrjen e informacionit zyrtar**, pas së cilës Bashkia Gramsh do të vlerësojë vijimin e procedurës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky njoftim bëhet për transparencë dhe për dijeni të aplikuesve.

KRYETARI

Besion A.FAZI

